



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr.Prot 1.352

Elbasan më 11/03/2026

RELACION

**Mbi dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin SHKURT 2026
KËSHILLIT BASHKIAK**

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin SHKURT 2026, 242 familje me një fond prej 1.120.354 lekë.

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie.

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Përgj. Sektori
Pranoi: Dr. Përgjithshëm

M. Duka
D. Shuli

ZV/ KRYETARI
ARMAND SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/03/ 2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/03/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/03/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Social

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **SHKURT 2026** për 242 familje me një fond prej **1.120.354** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Pranoi : Dr Përgjithshëm
Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka
D.Shuli
A.Hoxha
A.Merkja
A.Shehu

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE
DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
SHKURT 2026

I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2026

Shkurt	242 familje	fondi	1.120.354
Janar	256 familje	fondi	1.199.691

Për muajin Shkurt 2026 kemi 14 familje më pak se muaji paraardhës që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi është 79.337 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Ervis Isufi (nuk paraqitet)
2. Etleva Salla (riaplikon në sistem)
3. Ardjan Bylyku (riaplikon në sistem)
4. Suzana Banushi (riaplikon në sistem)
5. Jonida Karaj (riaplikon në sistem)
6. Miranda Bërdufi (riaplikon në sistem)
7. Orientela Rapaj (riaplikon në sistem)

II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Shkurt 2026

Shkurt	76 familje	fondi	233.000
Janar	81 familje	fondi	247.000

Për muajin Shkurt 2026 kemi 5 familje më pak se muaji paraardhës që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi i shpenzuar është 14.000 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

- | | |
|--------------------|--------------------------|
| 1. Flamur Jolla | (nuk paraqitet) |
| 2. Skënder Osmani | (nuk u paraqit) |
| 3. Ramadan Kreka | (përfitues në sistem) |
| 4. Ibrahim Cerriku | (larguar jashte shtetit) |
| 5. Lulzim Cani | (nuk paraqitet) |
| 6. Bujar Dërstila | (nuk paraqitet) |
| 7. Gramoz Dërstila | (nuk paraqitet) |
| 8. Pëllumb Qosja | (nuk paraqitet) |


Konceptoi

Specialiste Ermira Dika



Përgjegjëse Sektori

Miranda Duka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr 1353 Prot

Elbasan më 11 /03/2026

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHKURT 2026

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar , ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin SHKURT 2026 gjithsej 76 familje me një fond gjithsej 233.000 lekë .
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Pergj sektori
Pranoi: Dr Pergjithshem

M.Duka
D.Shuli

Zv/kryetari

Armand Shëhu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/03/ 2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/03/ 2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHKURT 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/03/2026

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin SHKURT 2026 për 76 familje me një fond prej 233.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Miratoi: Dr Përgjithshëm
Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka
D.Shuli
A.Hoxha
A.Merkja
A.Shehu

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E BUXHET-FINANCËS

Nr. 714 Prot.

Elbasan më 12.02.2026

RELACION

Mbi transferimin e aseteve, nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Shoqërinë Rajonale
Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SH.A.

Drejtuar:

KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit Nr.7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin", V.K.M. Nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël të organeve të pushtetit lokal dhe institucioneve qendrore" (i ndryshuar), Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar), propozojmë të kryhet transferimi i aseteve, nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SH.A. Këto transferime të pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit 2025. Bashkangjitur lista përkatëse sipas llogarive ekonomike.

Konceptoi: Përgjegjës Ornela Shehu

Pranoi: Drejt.Buxhet-Financës Alketa Merkja


Miratoi: Drejt.Përgjithshëm Servo Mehmeti

KRYETARI
Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Klaudia Krasnika



Nr	Emertimi i objektit	Shuma	Kodi	Analiza
1	Ndertim rrjeti KUZ ne zonat informale	68,807,741	P520AAA	2313600
2	Mbikqyrje "Ndertim rrjeti KUZ ne zonat informale"	1,169,550	P520AAA	2313600
3	Kolaudim "Ndertim rrjeti KUZ ne zonat informale"	100,000	P520AAA	2313600
	Shuma	70,077,291		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ .02.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë ____ .02.2026

***“Për transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale “Ujësjetllës
Kanalizime Elbasan” sh.a.”***

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____ .02.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Buxhet - Financës në bashki, për transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” sh.a., mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), në ligjin nr. 9228 datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (i ndryshuar), në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në ligjin nr. 10296 datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar), në VKM nr. 248 datë 10.4.1998 “Për miratimin e Planit Kontabël të organeve të pushtetit lokal dhe institucioneve qendrore” (i ndryshuar), si dhe në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a., sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Vlera	Institucioni transferohen ku
1	2136100	“Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale”	68,807,741	Shoqëria Rajonale “UKE” sh.a.
2	2136100	Mbikqyrje “Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale”	1,169,550	
3	2136100	Kolaudim “Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale”	100,000	
		Shuma	70,077,291	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet - Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elsid Zyma

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi:

Drejtori i Buxhet - Financës:

P A. Merkja

Drejtori Juridik dhe Informacionit:

M A. Hoxha

Pranoi:

Drejtori i Përgjithshëm i SHM:

S. Mehmeti

Miratoi:

Zv/kryetare:

K. Krasnika



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DDREJTORIA BUXHET FINANCË
SEKTORI I BUXHETIT**

Nr. 1039 prot.

Elbasan më 25 . 02. 2026

RELACION

“Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028”, si dhe përdorim i grantit për performance”.

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë !

Në kuadër të programit të bashkëfinancimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe FZSHS-së, në buxhetin e vitit 2026 janë parashikuar për investime dy objekte, me financim 10% i vlerës së projektit Bashkia dhe 90 % financim i FZSHS-së, si më poshtë :

1. “Ndërtimi i rrugës së re nga Rotonda e Varrezave deri në intersektimin me rrugën "Nos Josifi", në lagjen "Emin Matraxhiu".
Fondi i miratuar në buxhetin Bashkisë Elbasan për vitin 2026 = 6,327,415 lekë, ose 10% e vlerës së projektit.
2. “Rivitalizimi Urban i shesheve në anen veriore të Unazes Jugore, ndëlidhëse midis Kryqëzimit të Cerrikut dhe rrugës "25 Nentori".
Fondi i miratuar në buxhetin Bashkisë Elbasan për vitin 2026 = 7,752,216 lekë, ose 10% e vlerës së projektit.

a) Meqenëse projektet në fjalë nuk rezultuan fituese për financim nga FZSHS, duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e realizimit të tyre për komunitetin, kërkohet mundësia e financimit të plotë të investimit nga buxheti i Bashkisë.
Në këto kushte, Bashkia propozon financimin me tre vite buxhetorë të këtyre dy objekteve, konkretisht me 20 % të vlerës së projektit në vitin 2026, ndërsa pjesa tjetër e fondeve, ose 80% e vlerës së preventivit do të financohet në periudhën afatmesme 2027-2028 (tabela bashkëlidhur vendimit).

Bazuar në preventivat përfundimtarë, përcjellë me shkresën nr.827, datë 17.02.2026 të Drejtorisë së Projektimit Urban “Kërkesë për mbulim të plotë të investimit nga Bashkia për dy objekte”, për të plotësuar financimin me rreth 20 % për vitin 2026, kërkohet shtesë e fondeve në shumën **15,785,678 lekë**, për të dy objektet, përfshirë supervizimin dhe kolaudimin.

b) Gjithashtu, me shkesën nr.914, datë 19.02.2026, Drejtoria e Monitorimit kërkon rritje të fondit limit për projektin “Sistemi i kamerave të koshave të mbetjeve të ngurta (50 pika)”, pasi fondi 4,000,000 lekë i miratuar në buxhet është i pamjaftueshëm për të mbuluar shtrirjen e sistemit në 50 pika grumbullimi në të gjithë territorin e qytetit. Bazuar në preventivin teknik dhe nevojat operacionale të Bashkisë, kërkohet rritja e fondit në nivelin 8,500,000 lekë, ose **4,500,000 lekë** shtesë të fondit ekzistues për këtë objekt.

Në total, për të dy rastet e mësipërme kërkohet shtesë fonde për shumën 20,285,678 lekë.

❖ Për të financuar këtë shumë, propozojmë të përdorim burimet e fondeve si më poshtë :

1. Teprica nga prokurimi i objekteve :

- "Ndërtim i këmbëve dhe speronave të urës tip beli mbi përroin Lugaj, në fshatin Labinot Katund, Nj.Administrative Labinot Mal", (trashëg.2025), 1,000,000 lekë;
- "Mobilim i ambienteve ndihmëse të aktiviteteve sportive për grupmoshat e nxënësve të qytetit, Lagj. "Q.Stafa" (trashëg.2025), 1,000,000 lekë;
- "Mobilim i Çerdhes Nr.5, në lagjen "Kongresi i Elbasanit" (trashëg.2025), 8,139,543 lekë;

2. Teprica fondesh, objekte likujduar në fund të vitit 2025, pas miratimit të buxhetit 2026:

- "Blerje Grand Piano Yamaha, GC1", 1,554,000 lekë;
- " Fv barriera mbrojtëse", 1,000,000 lekë;
- Diferencë detyrimi kuotë anëtarësie K.Qarkut", 1,300,000 lekë;

3. Referuar ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksi 9 "Granti i Performancës për bashkitë" dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.20 dhe nr.1, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025", si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.18133/1, datë 24.12.2025, për Bashkinë Elbasan është akorduar fondi nga Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025, me burim finacimi nga buxheti i shtetit për shumën **6,292,134.83 lekë.**

Bashkitë kanë pavorsi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime".

Në tabelat bashkëlidhur relacionit, Ju do të gjeni shpenzimet dhe investimet në objekte të cilat i janë nënshtruar rishikimit (paksime dhe shtesa) që kanë të bëjnë me transferim fonde në buxhetin e Bashkisë për vitin 2026, si dhe tabelën me detajimin e fondit të akorduar nga Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025, me burim finacimi nga buxheti i shtetit.

Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", udhëzimin nr.2, datë 14.01.2026 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.154, datë 24.12.2025 për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028", Ju propozojmë të miratoni transferimin e fondeve dhe detajimin e shtesës së grantit për Performacë sipas tabelave bashkëlidhur projekt vendimit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin !

P.Sekt.Buxhetit: M.Behluli

Dr. Buxh. Fin.: A.Merkja

D.P.SH.M: S. Mehmeti

ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot.

Datë _____ .02. 2026

P/VENDIM

NR. _____ DATE _____ . 02. 2026

MBI

“Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028”, si dhe përdorim i grantit për performance”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .03.2026, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Transferim fonde për investime në buxhetin e vitit 2026, dhe periudhën afatmesme 2027-2028, si dhe përdorim i grantit për performance”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ”Udhëzimin plotësues nr.2, datë 14.01.2026 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, vendimin e Këshillit Bashkiak nr.154, datë 24.12.2025, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.20 dhe nr.1, datë 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025”, si dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr.18133/1, datë 24.12.2025,

VENDOSI


1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028, grant dhe të ardhura, njësia shpenzuese Bashkia dhe insitucionet vartëse, për financimin e objekteve për investime, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij p/vendimi.
2. Detajimin e fondit 6,292,134.83 lekë, Grant i Bazuar në Performancë, me burim financimi nga buxheti i shtetit, trashëguar nga viti 2025, sipas tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij p/vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe ASHPU.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

P/Sekt.Buxhetit : M.Behluli

Dr.Buxh.Fin. : A.Merkja

Dr.Juridike: A.Hoxha



SEKRETAR
Elsid Zyma

KRYETAR
Lutfi Lala

me leke

[illegible]

ne leke

Gr	Progr.	Funks.	Produkt.	Kap	Art	Kodi insit.	Institucionj	Shuma/2026	2027	2028	Total
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	"Ndertimi i rruges se re nga Rkotonda e varrezave deri ne intersektimin me rrugete "Nlos Josifi", Lajga "Ermin Matraxhin" (financim 2026-2028, vlera e projektit =64,900,688)	ASHPU	12,900,688	26,000,000	26,000,000	64,900,688
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Supervizim " "	ASHPU	564,894			564,894
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Kolaudim " "	ASHPU		84,734		84,734
00	AC109	04520	V452AAC	5+1	231	"Rivitalizimi Urban i sheshëve në anën veriore të uzazës Jugore ndelithese midis kryeqendrimit te Cerrikut dhe rruges "25 Nentori" (financim 2026-2028, vlera e projektit = 76,583,497 leke) (financie ardhur + gr.pertorm.)	ASHPU	9,291,362	31,000,000	30,000,000	70,291,362
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Supervizim " "	ASHPU	816,230			816,230
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Kolaudim " "	ASHPU		122,435		122,435
00	AE109	06260	V626AAF	5	231	"Sistemi i kamerave per koshat e mbejeve te ngurta" (shrese fondi)	Bashkia	4,500,000			
Totali :								28,073,174	57,207,169	56,000,000	136,780,343

W. Beebe

Tab. Nr.2

“Përdorim i grantit për performance, me burim financiar nga Buxheti i Shtetit” (fond i trashëguar nga viti 2025)

SHTESA:

ne leke

Gr	Progr.	Funks.	Produk.	Kap	Art	Kodi insit.	Institucioni	Shuma/2026
00	AC109	04520	V452AAC	1	231	Rivitalizimi Urban i shesheve ne anen vertore te unazes Jugore ndelidhese midis kryqezimit te Centkut dhe rruges "25 Nentori" (bashkefin. me FSHZH), (Vlera total projektit = 76,583,497 leke) (financ. te ardh. + gr. perform.)	ASHPU	6,292,134.83
Totali :								6,292,134.83

V. Belus Ju



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 1222 Prot.

Elbasan, më: 18.03.2026.

RELACION

“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan”.

KËSHILLIT BASHKIAK

K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse i relaton Këshillit Bashkiak si në vijim:

Bashkia Elbasan ka nisur procedurën për kalimin në pronësi të pasurive nr. 3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, fshati “Thanë”, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan pasi këto pasuri do të përdoren me qëllim realizimin e një projekti investues për ndërtimin e një pike grumbullimi për produkte agroushqimore, ndërtimin e serave për prodhime bujqësore dhe zhvillim të pemëtarisë.

Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë fillimin e procedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr. 3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, fshati “Thanë”, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan.

KRYETARI

Gledian Llatja

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika



Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P.U:

Drejtoria D.P.P.D.U:

Drejtoria P.Sh.M:

G. Kerri

G. Dyrmyshi

A. Merkja

M. Avllazagaj

K. Haxhihyseni

S. Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot.

Elbasan, më: ____ .03.2026.

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ Datë: ____ . ____ .2026.

“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan”.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike :

V E N D O S I :

1. Miratimin për fillimin e procedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elsid Zyma

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P.U:

Drejtoria D.P.P.D.U:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J. I:

Zv/Kryetar:

G. Kerri

G. Dyrmyshi

A. Merkja


M. Avllazagaj

K. Haxhihysemi

S. Mehmeti

A. Hoxha

K. Krasniqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT,
BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 1220 Prot.

Elbasan më, 18.03.2026

RELACION

Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Mehmet Sadik Vrapit banues në fshatin Murras të Njësisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,

Në zbatim të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, sektori përkatës, pas marrjes së kërkesës nga z. Mehmet Vrapit ka kryer konstatimin e banesës. Pas ardhjes së kërkesës në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile me nr. 2 prot. datë 6.1.2026, grupi i konstatimit për djegien e banesës në fshatin Murras të Njësisë Administrative Papër në datën 4.1.2026 (konfirmuar edhe nga Vërtetimi i SHMZSH nr. 01 datë 7.1.2026) ka hartuar proces-verbalin përkatës të datës 8.1.2026. Pas plotësimit të dokumentacionit, është vijuar me përcjelljen e dokumentacionit komisionit të vlerësimit të dëmeve ngritur në Bashkinë Elbasan me Urdhër nr. 64 datë 22.01.2025 “Per ngritjen e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera” për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga ekspertët e këtij komisioni. Ky komision, ka përgatitur preventivin mbi vlerën e dëmeve të objektit nga ana ndërtimore (sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga sistemi E-albania) duke përfshirë në të edhe vlerën e pajisjeve dhe orendive të dëmtuara (mbështetur në çmimet mesatare aktuale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ardhur me shkresë nr. 6024/1 prot. datë 22.4.2025) nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve ndërtimore në banesën së Z. Mehmet Vrapit, është në masën 1,562,268 lekë (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.
- Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi të banesës së Z. Mehmet Vrapit, është në masën 659,332 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë.


Në bazë të VKM-së cituar më sipër nr. 329 datë 16.05.2012 vlera e dëmeve në banesën e përcaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë merret nga pronari në masën prej 50% të shumës së nxjerrë. Pra në këtë rast $1,562,268^1 \times 50\% = 781,134$ lekë.

Kësaj shume i shtojmë vlerën prej 659,332 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë që është vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi.

Në përfundim nga komisioni i vlerësimit të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Mehmet Sadik Vrapit i takojnë $781,134 + 659,332 = 1,440,466$ (një milion e katërqind e dyzet mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

Duke Ju falenderuar,

<u>Konceptoi:</u>	Specialist	I. Hoxholli
<u>Miratoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
<u>Konfirmoi:</u>	Dr. PPMCMGBK	Sh. Çullhaj




KRYETARI
Gledian Llatja

Me Urdhër e Porosi
ZV/KRYETARI
Asim Sula



¹ Vlera e dëmeve në banesë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____.2026

Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Mehmet Sadik Vrapit banues në fshatin Murras të Njesisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028 si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Mehmet Sadik Vrapit, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në 1,440,466 (një milion e katërqind e dyzet mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.
2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $1,562,268^1 \times 50\% = 781,134 + 659,332^2 = 1,440,466$ lekë.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, i miratuar me VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028

¹ Vlera e dëmeve në banesë

² Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile). Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elsid Zyma

Lutfi Lala

Konceptoi:

Specialist

I. Hoxholli

Pranoi:

Drejtori MC

N. Sinani

Miratoi:

Dr. PPMCMDBPK Sh. Çullhaj

Dr. Buxhet Financë A. Merkja

Dr. Juridike A. Hoxha

Konfirmoi:

Zv/Kryetari

A.Sula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E MBIKEQYRJES DHE KONTROLLIT
DREJTORIA E SHMZSH

Nr. 02/11 Prot.

Elbasan më 07.01.2026

VËRTETIM

Për rënie zjarri

Nr.01, Datë 07.01.2026

Vërtetohet se më datë 04.01.2026, rreth ores 11:16' ne fshatin Murras, Nj. Adm. Paper, Bashkia Elbasan ka rene zjarr ne nje banese, ne pronesi te shtetasit Mehmet Vrapi.

Per shuarjen e zjarrit eshte njoftuar sherbimi zjarrfikes Elbasan i cili eshte nisur per ne vendin e ngjarjes me tre automjete dhe 8 efektiv zjarrfikes. Me nderhyrjen e sherbimit zjarrfikes eshte bere e mundur shuarja e zjarrit.

Nga renia e zjarrit eshte djegur komplet banesa me çati me te gjitha orendit qe kishte brenda.

Stacioni i MZSH-së Elbasan disponon dokumentacionin përkatës që vërteton këtë rast zjarri.

Ky vërtetim mbahet në 2 (dy) kopje dhe përpilohet me kërkesën e të dëmtuarit nga zjarri.

DREJTORI I SHËRBIMIT TË MZSH-së ELBASAN



I AUTORIZUAR

Emirjan Sota



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Elbasan

Njësia administrative Papër

Zyra e Gjendjes Civile 112



Date: 09.03.2026

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të viti 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Mehmet VRAPI	Sadik	Sulltane	M	Kryefamiljar	01-06-1948	I/e martuar	Pajun, Elbasan	Shqiptare	E80601012M
2.	Lirije VRAPI	Ali	Fatushe	F	Bashkëshorte	11-03-1951	I/e martuar	Pajovë, Elbasan	Shqiptare	F15311003M
3.	Genci VRAPI	Mehmet	Lirije	M	I Biri	22-03-1980	Begar/e	Elbasan	Shqiptare	I00322017G
4.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
5.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
6.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
7.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
8.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
9.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
10.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Përberja familjare, datë 04.01.2026



Vulozur elektronikisht nga Drejtoria e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date: 2026/03/09 09:15:30 +02:00
2389b0cb1004b89b97fc459a9d65281

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulozur me anë
të një procedurë automatike nga sistemi elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al eb:www.elbasani.gov.al

PREVENTIV I DËMEVE MATERIALE

Projektuesi: Ing. Arian Baku

Date: 12.1.2026

Objekti: Banesë e dëgjur e Z. Mehmet Sadik Vrapi

Adresa : Fshati Murras, Njesia Administrative Paper, Bashkia Elbasan

Sip. Baneses: 103 m2

Sip. Baneses: 103 m2

Sipërfaqja e dëgjur e banesës : 103 m2

Vlera e përllogaritur :

659,332 lekë


Nr	Numer	PAJISJE+ORENDI SHTEPIAKE	njesia	sasia	çmimi	vlera
1	61	Kend dhome	cope	1	50,207	50,207
2	50	Tavoline njesi	cope	1	10,634	10,634
3	51	Tavoline ngerenie	cope	1	26,048	26,048
4	52	Tavolinë TV	cope	1	13,851	13,851
5	28	Kundrabufe	cope	1	56,900	56,900
6	16	Karrige	cope	8	4,542	36,336
7	12	Frigorifer	cope	1	37,032	37,032
8	43	Sobe elektrike	cope	1	43,433	43,433
9	39	Pianurë	cope	1	17,055	17,055
10	24	Kondicioner 12	cope	2	43,961	87,922

11	53	Televizor	cope	2	22,749	45,498
12	9	Dollape Krobash	cope	2	43,853	87,706
13	27	Krevat dopio	cope	1	20,380	20,380
14	11	Dyshkek dopio	cope	1	17,037	17,037
15		Krevat tek	cope	2	-	-
16	20	Komodine	cope	4	4,572	18,288
17	64	Portmonto	cope	1	28,098	28,098
18	38	Perde	cope	4	11,958	47,832
19	47	Tapet	cope	3	5,025	15,075
SHUMA						659,332

Ky preventiv është hartuar nga Komisioni i Vleresimit miratuar me Urdher Administrativ të Kryetarit të Bashkisë nr. 64 date 22. 01. 2025 në bazë të procesverbalit të mbajtur në datë 8.1.2026 për banesën në fshatin Murras, Njesia Administrative Paper, duke u mbështetur në çmimet e ndërtimeve nga sistemi e-albania dhe çmimet e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr. 6024/1 prot. dt. 22.4.2025.

Komisioni

Ing. Arjan Baku
 Ark. Klajd Haxhinyseni
 Ju. Irida Hoxholli
 Ekon. Nevila Dybeli
 Adm. i Nj. A. Papër Arjan Vrapit




Drejtori i Mbrojtjes Civile

Ndriçim Sinani

[Signature]

MIRATOHET
 KRYETARI I BASHKISË
 Gledian Matja



Seriali: 92B32CDA-ADB-43C8-A6EA-9CC667D4ADAB

Projektuesi: Ing. Arian Baku

Date: 12.1.2026

Objekti: Banesë e djetur e Z. Mehmet Sadik Vrapit

Adresa : Fshati Murras, Njesia Administrative Paper, Bashkia Elbasan

Sip. Banesesi: 103 m2

Sip. Baneses se

diegur : 103 m2

Vlera e preventivuar

1,562,268.25

lekë

PREVENTIV PUNIMESH


NR.	KODI	EMERTIMI I PUNIMEVE.	NIËSIA	SASIA	CMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1	2.219	1. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATTTE Çati vendi e zakonshme me HD~8m tregulla marseljeze	m2	103	4,169.28	429,436.25
		SHUMA 1:				429,436.25
2	2.297/a	2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI Veshje tavani me kartonxhes	m2	97.76	6,583.43	643,596.02
3	2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	26	1,268.26	32,974.84
4	2.328	Patnium muri allçi (suko)	m2	12	489.26	5,871.14
		SHUMA 2:				682,442.00
5	2.404	3. PUNIME BOJATISJE Boje hidroplastike	m2	214.94	288.41	61,990.20
6	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	157	545.41	85,629.53
		SHUMA 3:				147,619.73
7	2.388/1	4. PUNIME DYER DRTARE F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	m2	5.67	14,263.71	80,875.25
8	2.395/2a	Dyer d/alumini dopio xham	m2	3.57	11,178.07	39,905.72
9	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	7.28	11,649.23	84,806.42
		SHUMA 4:				205,587.39
		5. INSTALIME PER NDRICIM				
10	2.480/1	F.V. Tub plasmasi Ø 14-17mm	ml	75	211.06	15,829.28
11	2.480/3	F.V. Tub plasmasi Ø 22-26mm	ml	85	298.31	25,356.27
12	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	115	44.55	5,123.71
13	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	182	61.41	11,175.89
14	2.481/3	F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	75	72.24	5,417.93

15	2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm	copë	30	225.64	6,769.05
16	2.486	F.V. Portollampa norm 10 A	copë	8	374.88	2,999.02
17	2.483	F.V. Çelesa e priza 10 A	copë	8	752.72	6,021.74
18	2.485	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	20	788.83	15,776.50
19	2.490	F.V. Kuader ndriçimi	copë	1	2,713.50	2,713.50
SHUMA 5:					97,182.88	
Shuma Analiza						1,562,268.25

Ky preventiv është hartuar nga Komisioni i Vlerësimit miratuar me Urdher Administrativ të Kryetarit të Bashkisë nr. 64 date 22. 01. 2025 në bazë të procesverbalit të mbajtur në datë 8.1.2026 për banesën në fshatin Murras, Njësia Administrative Paper, duke u mbështetur në çmimet e ndërtimeve nga sistemi e-albania dhe çmimet e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr. 6024/1 prot. dt. 22.4.2025.

Komisioni

Ing. Arjan Baku
 Ark. Klajd Haxhiyseni
 Ju. Irida Hoxholli
 Ekon. Nevila Dybelli
 Adm. i Nj. A. Papër Arjan Yrapi




Drejtori i Mbrojtjes Civile

Ndriçim Sinati

MIRATOHEFT
 KRYETARI I BASHKISË

Gledian Latija





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

AGJENCIA E MBIQYRJES DHE KONTROLLIT SH.M.Z.SH. SEKTORI I PARANDALIMIT ,
VERIFIKIMIT PËR RASTET E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE KOORDINIMIT ME STRUKTURAT
VULLNETARE

Elbasan më: 08/01/2026

PROCES -VERBAL KONSTATIMI

Bazuar në shkresën me Nr. Prot 2 Datë: 06/01/2026 me anë të së cilës Z. Mehmet Sadik Vrapi, banues në Fshatin Murras ,Njësia Administrative Paper i drejtohet AGJENCISË SË MBIQYRJES DHE KONTROLLIT SH.M.Z.SH. SEKTORI I PARANDALIMIT **Bashkia Elbasan** lidhur me demtimin që ka pasur shtëpia e tij si pasojë e zjarrit të rënë me dt.04.01.2026 , specialistët përkatës pranë kësaj agjencie shkuan dhe verifikuan në vend situatën nga ku konstatuan se:

Te dhenat e objektit:

Banesa 1 kat, e përbërë nga 4 dhoma +kuzhine+banje+verande.Mbulohet me cati lender druri+katrama dhe tjegulla marsejeze.Muret anësore dhe ndares janë tulle 25cm.Suvatim brenda-jashte.

Demet e verifikuara:

Si pasojë e zjarrit të rënë objekti (shtëpi banimi) ka pasur demtime serioze të tilla si djegie e të gjithë catise,dyerve dhe dritareve si dhe nxirrje e të gjithë mureve.Te gjitha orendite shtëpiake janë shkrumbuar.

Konkluzione:

Të gjendur përballë këtyre fakteve dhe gjendjes aktuale të terrenit, specialistët arritën në përfundimin se duhet të merren masa sa më parë për rindertimin e catise dhe rikonstruksionin e objektit shtëpi banimi.

Çfarë u përshkrua më sipër shoqërohet me fotot përkatëse. (Foto):





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT,
BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Elbasan më 12/1/2026

Proces – Verbal Vlerësimi

Ky proces – verbal mbahet sot 12.1.2026 në zbatim të urdhërit të brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr. 64 date 22.01.2025 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera” i përbërë nga Ing. Arjan Baku , Nevila Dybeli, Irida Hoxholli, Ark. Klajdi Haxhihyseni, si edhe administratori i Njesisë Administrative Papër për djegien e banesës së **Z. Mehmet Sadik Vrapit** banues në fshatin Murras, të Njesisë Administrative Papër.

Nga verifikimet në objekt rezultoi si më poshtë :

Pronaret e objektit : Z. Mehmet Sadik Vrapit

Vendndodhja e objektit : Fshati Murras, Njësia Administrative Papër.

Zona Kadastrale ZK. 2743, Pasuria nr. 83/1, Indeksi i Hartes EL: K-34-100-(206-D), Kordinatat në sistemin koordinativ KRGJSH : Y = 493524.43; X = 4548337.26

Sipërfaqja e banesës është : 103 m²

Sipërfaqja e demtuar e objektit është: 103 m²

Të dhënat e objektit:

Objekti në fjalë është një katëshe i përbërë nga kuzhina, koridori shpërndarës, 2 dhoma gjumi, banjoja, verandë. Muret perimetrale dhe ndarës janë nga 25 cm. Dyshemetë e të gjitha dhomave janë me pllaka importi. Dyert e brendshme janë prej druri përveç derës hyrëse dhe derës së tualetit që janë duralumin. Katër dritaret janë alumini dopio xham. Banjoja është e veshur me pllaka.

Dëmet në banesë:

Zjarri ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në të gjithë ambientet përveç tualetit. Ai ka demtuar të gjitha materialet e brendshme sipas preventivave të hartuara. Sistemi elektrik është jo funksional. Muret dhe tavanet janë demtuar plotësisht.

Suvatimet e mureve të brendshme janë demtuar rreth 10 % të totalit.

Përshkrimi i mësipërm shoqërohet me fotot përkatëse.



Ky Proces – Verbal pasi u lexua u firmos nga komisioni, Adm. i Nj. Adm. Papër dhe pronari i baneses.

KOMISIONI

Ing. Arjan Baku

Ark. Klajdi Haxhihyseni

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybeli

Adm. i Nj. Adm. Papër Arjan Vrap

PRONARI I BANESES

Z. Mehmet Sadik Vrap

Adm. i Nj. Adm. Papër

MIRATOHET

DREJTORI I MBROJTJES CIVILE

Ndriçim Sinani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT,
BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 1518 Prot.

Elbasan më, 18.03.2026

RELACION

Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Dalip Jonuz Verçani (i ndjerë) banues në fshatin Vidhas të Njesisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,

Në zbatim të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, sektori përkatës, pas marrjes së kërkesës nga i interesuari familjar i **Z. Dalip Jonuz Verçani** ka kryer konstatimin e banesës. Pas ardhjes së kërkesës në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile me nr. 1905 prot. datë 29.09.2025, grupi i konstatimit për djegien e banesës në fshatin Vidhas të Njesisë Administrative Papër në datën 27.9.2025 (konfirmuar edhe nga Vërtetimi i SHMZSH nr. 09 datë 8.10.2025) ka hartuar proces-verbalin përkatës të datës 29.9.2025. Pas plotësimit të dokumentacionit, është vijuar me përcjelljen e dokumentacionit komisionit të vlerësimit të dëmeve ngritur në Bashkinë Elbasan me Urdhër nr. 64 date 22.01.2025 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera” për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga ekspertët e këtij komisioni. Ky komision, ka përgatitur preventivin mbi vlerën e dëmeve të objektit nga ana ndërtimore (sipas koston mesatare të ndërtimit të banesave nga sistemi E-albania) duke përfshirë në të edhe vlerën e pajisjeve dhe orendive të dëmtuara (mbështetur në çmimet mesatare aktuale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ardhur me shkresë nr. 6024/1 prot. datë 22.4.2025) nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve ndërtimore në banesën e **Z. Dalip Jonuz Verçani**, është në masën **390,179 leke (treqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.**
- Vlera e dëmeve në pajisje dhe orëndi të banesës së **Z. Dalip Jonuz Verçani**, është në masën **54,487 (pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.**

Në bazë të VKM-së cituar më sipër nr. 329 datë 16.05.2012 vlera e dëmeve në banesën e përcaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë merret nga pronari në masën prej 50% të shumës së nxjerrë. Pra në këtë rast $390,179 \times 50\% = 195,090$ lekë.

Kësaj shume i shtojmë vlerën prej **54,487 (pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë)** lekë që është vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi. Familja e znj. Xheke Verçani nga fatkeqësia e ndodhur banesës së saj ka humbur jetën edhe bashkëshorti i saj z. Dalip Verçani, vërtetuar nga certifikata e vdekjes e datës 9.10.2025, nxjerrë nga zyra e gjendjes civile nr. 112 e Njesisë Administrative Papër. Për këtë arsye familjes i takon në bazë të VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III/3/a , **500,000 (pesëqind mijë)** lekë për familjarin e tyre që ka ndërruar jetë.

Në përfundim nga komisioni i vlerësimit të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Dalip Jonuz Verçani (i ndjerë)** i takojnë $195,090 + 54,487 + 500,000 = 749,577$ (shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

Duke Ju falenderuar,

<u>Konceptoi:</u>	Specialist	I. Hoxholli
<u>Miratoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
<u>Konfirmoi:</u>	Dr. PPMCMBP	Sh. Çullhaj



KRYETARI
Gledian Llatja

Me Urdhër e Porosi
ZV/KRYETARI
Asim Sula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____.2026

Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Dalip Jonuz Verçani (i ndjerë) banues në fshatin Vidhas të Njësisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028". si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Dalip Jonuz Verçani (i ndjerë)**, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në vlerën totale prej **749,577** (shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.
2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $390,179^1 \times 50\% = 195,090 + 54,487^2 + 500,000^3 = 749,577$ lekë.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak ”;

¹ Vlera e dëmeve në banesë

² Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi

³ Masa e ndihmës financiare për personik që ka ndërruar jetë nga zjarri i rënë

VKB nr. 154 datë 24.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elsid Zyma

Lutfi Lala

Konceptoi: Specialist I. Hoxholli
Pranoi: Drejtori MC N. Sinani
Miratoi: Dr. PPMCMDBPK Sh. Çullhaj

Dr. Buxhet Financë A. Merikja
Dr. Juridike A. Hoxha

Konfirmoi: Zv/Kryetari A.Sula

Nr. [] [] [] [] [] []

Miratuar nga INSTAT me shkresë Nr.266 datë 05.04.2004
në bazë të Ligjit për Statistikat Zyrtare Nr. 9180 data
05.02.2004. Dërgohet nga zyra e Gjykatës Civile e Rrethit
në INSTAT brenda datës 7 të muajt pasardhës.

SKEDË VDEKJE D-4

VËRTETIM MJEKSOR I SHKAKUT TË VDEKJES

Emri, Atësia, Mbiemri i të vdekurit

Data e vdekjes:

dita

27

muaji

09

viti

2025

Data e lindjes:

dita

24

muaji

09

viti

1947

PJESA I - Çertifikata mjeksore

A - TË DHËNA MJEKSORE

I. VENDI I VDEKJES		II. KA QENË NË TRAJTIM MJEKSOR	
Në shtëpi	☒ 1	Po	☐ 1
Institucion mjeksor	☐ 2	Jo	☒ 2
Të tjera	☐ 3		
(specifiko)			

III. SHKAKU I VDEKJES

a-Natyrle (nëse, jo kalo rubrika b)	b-Violente
